



UNIVERSITETI I PRISHTINËS
"HASAN PRISHTINA"
FAKULTETI I SHKENCAVE MATEMATIKE NATYRORE

Rr. Eqrem Çabej, 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës
Tel: +381-38-249-873 • E-mail: fshmn@uni-pr.edu • www.uni-pr.edu

FSHMN

Ref. nr.

1590

Prishtinë, Dt.

03.06.2026

RAPORT VLERËSIMI TË DORËSHKRIMIT TË PUNIMIT TE DIPLOMES
MASTER

FAKULTETI	ShMN
Departamenti/ Programi	Biologji/Biologji
Projektpropozimi	Veçoritë faunistike dhe ekologjike të merimangave (Arachnida: Araneae) në Komunën e Mitrovicës Faunistic and ecological features of spiders (Arachnida: Araneae) in the Municipality of Mitrovica
Kandidati	Besnik Çitaku
Mentori	Prof. Dr. Halil Ibrahim
Aprovimi i projekt propozimit në	Datë: 14.07.2025
Këshillin e Fakultetit	Vendimi nr.: 2380

Vlerësimi i dorëshkrimit

Tema e masterit, "**Veçoritë faunistike dhe ekologjike të merimangave (Arachnida: Araneae) në Komunën e Mitrovicës**" i kandidatit Besnik Çitaku është punuar në Departamentin e Biologjisë të Fakultetit të Shkencave Matematike-Natyrore, përkatësisht laboratorin e Zoologjisë të Universitetit të Prishtinës.

Dorëshkrimi është i shkruar në 26 faqe me radhor normal ku janë të përfshirë këta kapituj: Hyrja, Materiali dhe metodat e punës, Rezultatet, Diskutimi, Përfundimi, dhe Referencat. Gjithashtu në punim janë të prezantuar: 13 tabela dhe 5 figura. Kandidati gjatë shkuarjes së dorëshkrimit ka shfrytëzuar literaturë të begatshme përkatësisht 23 njësi bibliografike dhe burime tjera nga interneti.

Puna është zhvilluar sipas dinamikës së paraparë me planin dhe programin e punës dhe është

realizuar në tri faza:

1. Hulumtimi në bazë të të dhënave të literaturës dhe puna praktike eksperimentale në teren.
2. Përpunimi i të dhënave, dhe
3. Shkrimi i tezës së masterit.

Qëllimi i kësaj teme të masterit ka qenë vlerësimi i faunës së arcanidave dhe aspektet taksonimike të llojeve të merimagnoreve Balkanin Përendimor. Me anë të këtij hulumtimi janë ofruar 15 lloje të merimagave që i perkasin 10 familjeve. Studimi është kryer në 10 lokalitete lokalitete të ndryshme në komunën e Mitrovicës.

Në kapitullin e Hyrjes kandidatja përshkruan në përgjithësi karakteristikat, grupeve shtazore të hulumtuara, rendësin e tyre dhe ekosisteme. Gjithashtu në këtë kapitull janë përfshirë edhe qëllimi i hulumtimit sebashku me pikat kyçe të këtij hulumtimi si dhe karakteristikat e grupeve shtazore të konstatuar gjatë këtij hulumtimi.

Në kapitullin Materiali dhe Metodat e punës janë paraqitur të dhënat për për zgjedhjen e objektit të hulumtimit, mënyrën e hulumtimit në teren dhe mënyrën e përpunimit të të dhënave, dhe sekuencimi i mostrave. Në këtë kapitull shtjellohet në detaje metoda e marrjes së mostrave, konservimi i tyre si dhe determinimi.

Në kapitullin Rezultatet kandidati jep detajisht të dhënat e fituara gjatë këtij hulumtimi. Të dhënat janë paraqitur në formë tabelare dhe në formë grafike duke e pasqyruar për secilin lokalitet përbërjen e faunës së merimangave.

Në kapitullin e Diskutimit kandidati i diskuton të dhënat e fituara gjatë këtij hulumtimi me hulumtimet e kryera më parë.

Adaj, konsiderojmë se kandidati i ka plotësuar të gjitha kushtet për të propozuar KSHM të Departamentit të Biologjisë përkatësisht FSHMN që të aprovojë këtë raport dhe ti lejoj kandidatit mbrojtjen e kësaj teme të masterit me titullin e lartshënuar.